

Informatat mbi grantin

Instrumenti:	Grant Institucional
Organizata Implementuese (përfshirë partnerin nëse është e aplikueshme):	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA
Kontaktet e organizatës: Adresa, email, telefonat, web faqja	www.orca-ks.org info@orca-ks.org orca.comms@gmail.com +38345234994 Rruga Henrik Baric nr 6, Prishtinë, Kosovë, 10000
Kohëzgjatja:	Data e fillimit: 01.01.2021 Data e përfundimit: 31.12.2023
Buxheti i përkrahur nga programi:	€ 114,650.00
Buxheti total:	€ 640,657.00
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Grupet e synuara:	Studentët, stafi akademik/menaxhues i universiteteve publike, si dhe zyrtarë nga institucione tjera të arsimit të lartë.
Përmbledhje e intervenimit:	Ky grant synon demokratizimin e hapësirës universitare në Universitetin e Prishtinës, duke revitalizuar organizmin studentor që do të çojë në angazhimin e studentëve në një jetë aktive në jetën publike në përgjithësi dhe universitare në veçanti. Po ashtu, synon që monitorimet dhe hulumtimet ekzistente të organizatës t'i fuqizojë me metoda të demokracisë pjesëmarrëse. Kjo synohet të arrihet: përmes themelimit të Qendrës për Aktivizmin Studentor e cila do të shërbejë si vatër e aktivizmit studentor dhe e krijimit të nismave të reja studentore; përmes themelimit të një platforme mediale studentore që merret me arsim, ku gazetës së shtypur satirike të studentëve "Tempulli i Dijes", i shtohet edhe ueb faqja e cila përveç informimit do të shërbejë edhe si platformë diskutimesh; përmes metodave të demokracisë pjesëmarrëse - avokimit institucional duke ushtruar gjyqësinë strategjike, apo edhe duke sinjalizuar publikisht përmes aksioneve simbolike e protestuese për probleme të veçanta që përbëjnë fenomene negative në sferën e arsimit të lartë.

Bashkëfinancuar nga: